ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

A N K E S Ë

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	**616-23-10571-5-1-1**
Nr i brendshëm	**616 23 113/1 511**

Sa i përket tenderit për : **Rekonstruimi i rrugës Rexhep Luci dhe Qamil Hoxha** -**RITENDEER**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

GOE: "VALDRINI SH.P.K ; NN SHKËMBI & LD Construction shpk
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

DRENAS
(Adresa)

DRENAS
(Vendi)

13 000
(Kodi postar)

+383-49-623-188
(Numri Telefonit)

N/A
(Numri i Faks-it)

QËNDRIM KURRUMELI
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

valdrini.shpk@hotmail.com
(Adresa elektronike)

(Nënshkrimi dhe vula)

09/09/2024
(Data e parashtrimit të kërkesës)

SH.P.K VALDRINI GLLOGOC

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim: **N/A**

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Autoriteti kontraktues – **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**, me date 02.10.2023 ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull të kontratës: : **Rekonstruimi i rrugës Rexhep Luci dhe Qamil Hoxha -RITENDEER**
,Me nr. Te prokurimit: 616-23-10571-5-1-1 si në vijim:

1. Procedurë e hapur,
2. Kontrate publike,
3. Punë, Vlerë e madhe
4. Vlera e parashikuar e kontratës: **1,100,000.00 euro**
5. Kriteri për dhënie të kontratës: **Ekonomikisht me i favorshëm!**

Afati i fundit për dorëzim te tenderëve, ka qen me date 26.10.2023 ora:13:30,
Vendi: Zyra e Prokurimit
Takimi për hapjen e tenderëve ka qen me datë 26.10.2023 ora:13:30 ne platformën elektronikë te prokurimit.

Me date 28.08.2024 është publikuar B58 Vendimi i Autoritetit Kontraktues per dhënie te kontrates dhe letrat standarde për tenderuesit e pasuksesshem.
Bashkëngjitur ne këtë titull të këtij njoftimi kemi pranuar njoftimin për B42 Letrën standarde te tenderuesit te eliminuar.
Me date 02.09.2024 kemi bere kerkese per rishqyrtim pranë komunes së Prishtinës.
Me date 04.09.2024 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkeses pe rishqyrtim si të pa bazuar.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Hapja e tenderit është bërë në mënyrë elektronike në vendin e caktuar dhe ne kohen e caktuar, me 26.10.2023 në ora 13:30 h. Nuk kemi vërejtjeje!

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Të pa kënaqur me Vendimin e AK- Autoriteti kontraktues – **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES** dhe në pajtim me nenin 108A të LPP-së parashtrojmë kërkese për rishqyrtim kundër;

- **Njoftimit për eliminimin (Letrën standarde për tenderues te pasuksesshem) nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit.**
- **Njoftimit te Vendimit te AK për rezultatin e tenderit te datës : 28.08.2024**

Me date 02.09.2024 kemi bërë kerkese per rishqyrtim pranë komunes së Prishtinës.
Me date 04.09.2024 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkeses pe rishqyrtim si të pa bazuar.

Prandaj te pa kënaqur me Vendimin e AK-Autoritetit kontraktues-komuna Prishtinës,Për shkak të shkelje të dispozitave të;

- Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në

tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së) dhe atë;

- Nenin 1, Qëllimi, par 1 dhe 3.
- Nenin 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, par 1.
- Nenin 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi, par 1,2 dhe 6
- Neni 10, Qasja në dokumentacion
- Nenin 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave, par 1, nen par 1.1 ; 1.2 dhe par 3.
- Nenin 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par 2 dhe 4
- Nenin 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës, par 1, nen par 1.1
- Nenin 69, Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, par 1.
- Nenin 72 të LPP-së, të Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, par 1 dhe 2.

II. Dispozitat e Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi RRPP) dhe atë:

- Nenin 38, Sqarimi i Tenderëve, par 38.1
- Nenin 40, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par 40.1; 40.2; 40.6 nen par a; b dhe c
- Nenin 97, Shkeljet e rënda, par 97.1 nen (d) dhe (o)

III. Dispozitat e Udhëzuesit nr. 01/2023 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi UA2) dhe atë:

- 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

ME DATË 15.11.2023 AK KA KERKUAR NGA NE GOE : **"VALDRINI" SH.P.K ; NN SHKËMBI & LD CONSTRUCTION SH.P.K SQARIME LIDHUR ME OFERTEN TONË , ME DATE : 20.11.2023 I KEMI DERGUAR SQARIMET E NEVOJSHME.**

ME DATË: 22.11.2023 AK NA KA SHPALLUR FITUES GOE: "VALDRINI" SH.P.K ; NN SHKËMBI & LD CONSTRUCTION SH.P.K ME QMIMIN ME TE LIRE TE OFRUAR DHE SI GOE I PERGJEGJSHEM.

ME DATE 27.11.2023 PAS KERKESAVE PER RISHQYRTIM NGA DY OFERTUES TE TJERE AK E PEZULLON LANDEN, ME DATE 06.12.2023 AK DERGON NJOFTIMIN PER TE KTHYER LENDEN NE RIVLERSIM. QE PREJ ATEHER E DERI ME DATE : 30.04.2024 AK PUBLIKON VENDIMIN DUKE SHPALLUR FITUES GOE: FLAMURI V & BENITA COMPANY SH.P.K.

SI ESHTE E MUNDUR QE HEREN E PARE TE VLERSIMIT TE OFERTAVE NE ISHIM TE PERGJEGJSHEM DHE ISHIM SHPALLUR FITUES NDERSA TASH NUK DO TE JEMI TE PERGJEGJSHEM SIPAS AK !

AK KA RËNË NE KUNDERSHTIM ME VENDIMET E SAJË!
ME DATË : 05.05.2024 NE SI GOE KEMI BË KERKESE PER RISHQYRTIM NE KOMUNE TE PRISHTINES , ME DATË: 10.05.2024 AK KA KTHYER PERGJIGJIEN SI VENDIM I PA BAZUAR PER PRETENDIMET TONA.
ME DATË: 20.05.2024 NE KEMI BË ANKESË NË OSHP LIDHUR ME KETE PROCEDURE TE PROKURIMIT , NDERSA ME DATË: 15.07.2024 OSHP KA DERGUAR VENDIMIN SI PJESËRISHT TE BAZUAR LIDHUR ME KETE PROCEDURE TE PROKURIMIT , KY VENDIM ESHTE NE FAVOR TONË SI GOE PASIQE OSHP REKOMANDON QE AK TE KTHEJ LENDEN NE RIVLERSIM DHE TE VENDOSE DREJTË , POR AK NUK KA ZBATUAR VENDIMIN E OSHP DHE KA VEPRUAR NE KUNDERSHTIM ME OSHP DUKE SHPALLUR TE NJEJTIN FITUES GOE : FLAMURI V SHPK & BENITA COMPANY SHPK I CILI NUK I PLOTESON KUSHTET E DT.

- Pretendimet lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore: **Sa i përket Formulari Letrës standarde për tenderues te ELIMINUAR.**

E kundërshtojmë në tërësi vendimin e AK lidhur me letrën standarde për tenderues te pasuksesshem, për faktin se arsyetimi i AK sa i përket eliminimit të ofertës tonë është i pa bazuar dhe në shkelje të kërkesave te përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT dhe në shkelje të dispozitave Ligjore të LPP-së.

Autoriteti kontraktues **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES** na eleminon kinse për arsyet:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:
Lidhur me Grupin e Operatorëve Ekonomik: ***GOE "Valdrini ShPK & Ibrahim Kurrumeli BI & LD Construction ShPK"*** komisioni evidentoi gjetjet si në vijim:
1. Sa i përket kërkesës së DT *"Një (1) Inxhinier i Ndërtimtarisë – Gjeodezisë 5 vite pervoje pune pas diplomimit"*, GOE ka përcaktuar z. Luan Abazi. Fillimisht duhet sqaruar se sipas kësaj pike të kërkesës në fjalë të dosjes janë kërkuar pesë (5) vite përvojë të punës pas datës së diplomimit. Për të dëshmuar këtë fakt, përmes dosjes së tenderit janë kërkuar ose kontratat e punës me punëdhënësit në fjalë ose vërtetimet nga ATK përmes të cilave dëshmohet përvoja e kërkuar e punës prej pesë (5) viteve. Në rastin konkret nuk janë dorëzuar as kontrata të punës të cilat do të mund të dëshmonin se personi në fjalë (z. Luan Abazi) ka së paku pesë (5) vite përvojë të punës pas diplomimit dhe as vërtetimet nga ATK - Listat e pagave. Sa i përket parakontratës së dorëzuar, duhet cekur se kjo kontratë është lidhur me datë 26.10.2023 dhe nuk dëshmon asnjë ditë të përvojës së punës pas diplomimit pasi që manifeston vetëm një marrëveshje paraprake që të themelohet marrëdhënia e punës me kusht që të nënshkruhet kontrata për të cilën kanë aplikuar në

këtë aktivitet të prokurimit. Sidoqoftë kjo parakontratë nuk ka asnjë vlerë provuese në kuptim të kërkesës së përcaktuar me dosjen e tenderit pasi që nuk është kërkuar të dorëzohet nga autoriteti kontraktues dhe si e tillë nuk mund të ketë asnjë efekt juridik në vlerësimin e tenderëve. Përderisa nuk janë dorëzuar as kontratat e punës dhe as vërtetimet përkatëse nga ATK, nuk është arritur që të dëshmohet përvoja e punës pas diplomimit për personin në fjalë. Vlen të thuhet po ashtu se as përmes ofertës mirëpo as përmes sqarimeve shtesë nuk është dorëzuar diploma bachelor (studimet themelore) për inxhinierin e gjeodezisë z. Luan Abazi. Në vend të kësaj është dorëzuar diploma e studimeve master megjithatë është dashur patjetër që të dorëzohet edhe diploma e studimeve bachelor pasi që e njëjta është kërkuar edhe përmes dosjes së tenderit ku askund nuk përmendet diploma master. Rrjedhimisht GOE nuk ka arritur që të përmbushë këtë kërkesë të dosjes së tenderit.

-Pergjigjia jonë : Ky pretendim i AK nuk qendron , pasi qe Inxhinieri i Gjeodezise z.Luan Abazi ne Cv-ne e ofruar shihet qarte se ka punuar qe nga viti 2009 e deri me tani dhe ka nje pervoje pune shume te madhe mbi 15 vite. Po ashtu me oferten tone te dorzuar diten e ofertimit kemi ofruar deshmite e kerkuara Pervoja e punes mbi 5 vite permes vertetimave te Atk-se nga viti 2018 deri 2023 te cilet deshmojne se z.Luan Abazi ka pervojen e kerkuar dhe poashtu ka biznesin e tij personal si person fizik per Aktivitetet inxhinierike dhe keshillimit teknik , kompani e cila mirret me Matje Gjeodezike ne te cilen punon Luan Abazi si Gjeodet i licensuar te cilit i paguhen tatimet automatikisht nga kompania e tij te cilin e kemi deshmuar me vertetima te atks per vitet : 2018,2019,2020,2021,2022 dhe 2023 per te cilat vite i ka vetpaguar tatimet e tij nga kompania e tij si person fizik, pervoja e tij si gjeodet i njihet edhe nga kompania e tij pasiqe mirret me Gjeodezi sepse nje gjeodet i licensuar per te kryer sherbime gjeodezike ne menyre ligjore qe te behen pagesa dhe te paguhen tatime shtetit duhet qe te operoje si biznes.

AK lidhur per kete pretendim eshte dashur te kerkoje sqarime shtesë ne menyre qe ne ti ofrojme deshmi shtese edhe permes Trustit pensional ne te cilin figuron Luan Abazi qe nga viti 2010 e deri tani.Ne po ju ofrojme si deshmi edhe trustin pensional te ing.Luan Abazi per periudhen 2010 deri 2024. Si e tille e ploteson bindshem kerkesen e AK ne dt.

2. Nga administrimi me ofertën e parashtruesit është gjetur se CV e inxhinierit Faruk Kryeziu nuk i përmbush kërkesat minimale sipas dosjes së tenderit. Në fakt po të analizohet CV si e vetme, është shumë e vështirë që të kuptohet se CV e kujt është sepse aty nuk figuron as emri i personit për të cilin është dorëzuar CV. Si e tillë CV më shumë i përngjan një liste të projekteve kur pretendohet se ka marrë pjesë personi në fjalë sesa një CV me të dhënat bazike të një biografike standarde. Prandaj në kuptim të UPP lidhur me nenin 69 të LPP ku përcaktohet se kur "CV nuk përmbush kërkesat - Refuzo tenderin pa kërkuar informacione mëtejshëm". Vlen të shtohet se këtë fakt GOE nuk e ka kontestuar fare me kërkesën për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin me rastin e vlerësimit të parë.

-PERGJIGJIA JONË: Ky pretendim i AK nuk qendron , pasi qe Inxhinieri z.Faruk Kryeziu ne Cv-ne e ofruar shihet qarte se kjo CV eshte e nenshkruar nga Vetë inxhinieri Faruk Kryeziu dhe poashtu figuron imella e tijë personale dhe poashtu CV eshte e dorzuar sebashku me dokumentacionin e tij(fajlli 22.Ingjinieri Faruk kryeziu) si inxhinier dhe i perket pikerisht Faruk Kryeziut , poashtu nese keni dyshime per kete CV mund ta vertetoni edhe permes trustit pensional edhe permes kontaktit me vet inxhinierin F.K.

3. Lidhur me kërkesën e DT "*Një (1) menaxher i projektit - inxhinier i ndertimtarisë në drejtimin konstruktive, me së paku 7 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit*", ju keni përcaktuar z. Hivzi Kabashi. Bazuar në diplomën e dorëzuar për menaxherin e projektit - inxhinierin e ndërtimtarisë, është gjetur se i njëjti ka diplomuar dhe ka marrë titullin "Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë" me datë 09.03.2022. Ky fakt është provuar përmes kopjes së noterizuar të diplomës. Sipas dosjes së tenderit është kërkuar që menaxheri i projektit të ketë së paku shtatë (7) vite përvojë të punës profesionale pas datës së diplomimit. Duke marrë parasysh faktin që njoftimi për kontratë është publikuar në tetor të vitit 2023, rezulton se menaxheri i projektit i cili duhet të jetë edhe inxhinier i ndërtimit - drejtimi konstruktiv nuk e përmbushë kërkesën për përvojë të punës prej shtatë (7) viteve pas datës së diplomimit. Duhet cekur faktin që në diplomën e menaxherit potencohet që i njëjti ka regjistruar studimet në vitin 2001 ndërsa ka përfunduar provimet në vitin 2006, mirëpo nuk ka arritur të diplomoj deri në vitin 2022. Periudha kur janë regjistruar dhe kur janë përfunduar provimet (2001 deri 2006) korespondojnë edhe me datat që janë evidentuar në CV të menaxherit. Mirëpo duhet pasur parasysh që përmes dosjes së tenderit janë kërkuar shtatë (7) vite përvojë të punës profesionale pas datës së diplomimit. Pra nuk është fare relevante nëse ndërmjet datës kur janë përfunduar provimet dhe datës së diplomimit ekziston një hapësirë e konsiderueshme kohore (si në rastin konkret). Për këtë aktivitet të prokurimit duke marrë parasysh dosjen e tenderit është relevante vetëm data e diplomimit (09.03.2022). Komisioni vlerësues ka verifikuar nëse diploma në rastin konkret është diplomë dublikat mirëpo me këtë rast ka gjetur se se në dokumentin në fjalë (në diplomë) nuk përmendet fare fjala "duplikat" ngjashëm sikurse nuk përmendet kjo fjalë as në vërtetimin e noterit që është dorëzuar lidhur me këtë diplomë. Në anën tjetër as GOE nuk ka dorëzuar asnjëherë një vërtetim përmes të cilës do të mund të konfirmohej një fakt i tillë. Vlen të shtohet se të gjitha të gjeturat më sipër janë në përputhje të plotë me vendimin e Panelit Shqyrtues OSHP:2024/0438 të datës 15.07.2024 ku në faqen 5 te pjesa e të gjeturave të panelit shqyrtues thuhet se "*Për H.K., vlerësohet se data e diplomimit është kritike për vërtetimin e përvojës së tij...*". Në rastin konkret data e diplomimit respektivisht data 09.03.2022 është marrë si datë kritike sipas të cilës nuk është arritur që të përmbushet kërkesa në fjalë e dosjes së tenderit.

-PERGJIGJIA JONË : Ky pretendim i AK nuk qendron , pasi qe Inxhinieri Hivzi Kabashi ka diplomuar ne vitin 2006 ashtu siqë shenon ne diplomen e tij STUDIMET I MBAROI MË 27 TETOR 2006. Dhe e ploteson bindshem kerkesen e AK 7 vite pervoj pune pas diplomimit , ndersa data Prishtine ,9 mars 2022 eshte date e rinxjerrjes se diplomes(duplikat) , eshte jo profesionale per kete vlersim te AK lidhur me leximin e datave te mbarimit te studimeve pasi qe eshte shume e kjarte qe studimet i ka mbaruar ne vitin 2006 (kjo eshte data e diplomimit dhe kjo date 27 tetor 2006 mirret si date e mbarimit te studimeve) , si deshmi Ne po ju sjellim edhe diplomen e vjeter ,poashtu nese keni pakjartesi mund te merrni ndonje konfirmim/sqarim nga Universiteti i Prishtines lidhur me kete diplome.

4. Lidhur me kërkesën e DT *"Një (1) Inxhinier i Ndërtimtarisë – Drejtimi Konstruktivë apo fushës së ndërtimit të rrugëve 5 vite pervoje pune pas diplomimit"*, GOE ka përcaktuar z. Faruk Kryeziu. Fillimisht duhet sqaruar se sipas kësaj kërkese të dosjes janë kërkuar pesë (5) vite përvojë të punës pas datës së diplomimit. Për të dëshmuar këtë fakt, përmes dosjes së tenderit janë kërkuar ose kontratat e punës me punëdhënësit në fjalë ose vërtetimet nga ATK përmes të cilave dëshmohet përvoja e kërkuar e punës prej pesë (5) viteve. Në rastin konkret nuk janë dorëzuar kontrata të punës të cilat do të mund të dëshmonin se personi në fjalë (z. Faruk Kryeziu) ka së paku pesë (5) vite përvojë të punës pas diplomimit. Sa i përket parakontratës së dorëzuar, duhet cekur se kjo kontratë është lidhur me datë 26.10.2023 dhe nuk dëshmon asnjë ditë të përvojës së punës pas diplomimit pasi që manifeston vetëm një marrëveshje paraprake që të themelohet marrëdhënia e punës me kusht që të nënshkruhet kontrata për të cilën kanë aplikuar në këtë aktivitet të prokurimit. Sidoqoftë kjo parakontratë nuk ka asnjë vlerë provuese në kuptim të kërkesës së përcaktuar me dosjen e tenderit pasi që nuk është kërkuar të dorëzohet nga autoriteti kontraktues dhe si e tillë nuk mund të ketë asnjë efekt juridik në vlerësimin e tenderëve. Sa i përket dëshmisë mbi pesë (5) vite të përvojës së punës pas diplomimit, janë dorëzuar edhe disa vëretime nga ATK për vitet 2018-2023. Në fakt këto vërtetime nuk janë dorëzuar përmes ofertës por janë dorëzuar vetëm pas sqarime shtesë të datës 20.11.2023 të kërkuara nga autoriteti kontraktues. Mirëpo pas analizimit të këtyre vërtetimeve është gjetur si vijon:

- Faruk Kryeziu nuk figuron fare në listën e punëtorëve në vërtetimin e ATK për vitin 2018 dhe për vitin 2019.
- I njëjti është evidentuar si punonjës vetëm në vërtetimin e ATK të vitit 2020 ku përcaktohet se personi në fjalë (z. Faruk Kryeziu) gjatë vitit 2020 i ka vetëm tetë (8) muaj të përvojës së punës konkretisht nga muaji i pestë (5) deri te muaji i dymbëdhjetë (12).
- Tutje në vitin 2021 personi në fjalë sipas vërtetimit të ATK figuron se gjatë vitit 2021 i ka vetëm njëmbëdhjetë (11) muaj të përvojës së punës konkretisht nga muaji i dytë (2) deri te muaji i dymbëdhjetë (12).
- Tutje në vitin 2022 sipas vërtetimit të ATK është gjetur se z. Faruk Kryeziu i ka dymbëdhjetë (12) muaj të përvojës së punës respektivisht vitin e plotë.
- Ndërsa në vitin 2023 sipas vërtetimit të ATK është gjetur se z. Faruk Kryeziu i ka nëntë (9) muaj të përvojës së punës konkretisht nga muaji i parë (1) deri te muaji i nëntë (9).

Nga sa u tha më sipër përmes vërtetimeve të ATK (listës së pagave) të dorëzuara nga GOE është konstatuar se z. Faruk Kryeziu i ka vetëm dyzet (40) muaj përvojë të punës. Në anën tjetër përmes dosjes së tenderit janë kërkuar së paku pesë (5) vite apo

gjashtëdhjetë (60) muaj të përvojës së punës pas diplomimit. Bazuar në dokumentet që janë dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar përmes ofertës por edhe në dokumentet shtesë të dorëzuara si sqarime me datë 20.11.2023, tenderuesi i rekomanduar për këtë pikë të kërkesës (inxhinier i ndërtimtarisë - drejtimi konstruktiv) nuk ka arritur të dëshmoj se z. Faruk Kryeziu i ka së paku pesë (5) vite të përvojës së punës pas diplomimit. Kjo pasi që nuk janë dorëzuar kontratat me punëdhënësit me të cilët është zhvilluar kjo marrëdhënie e punës sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Në anën tjetër as përmes vërtetimeve nga ATK - listave të pagave nuk është vërtetuar se personi në fjalë e ka pëmbushur kërkesën e përvojës së punës prej pesë (5) viteve. Lidhur me personin në fjalë (z. Faruk Kryeziu) janë dorëzuar edhe disa dokumente shtesë (referenca, deklarata, etj) të cilat nuk janë kërkuar nga autoriteti kontraktues përmes dosjes së tenderit dhe si të tilla nuk mund të manifestojnë asnjë ndikim mbi vlerësimin përfundimtar të ofertës përkatëse.

Vlen të shtohet se Paneli Shqyrtues përmes vendimit OSHP:2024/0438 të datës 15.07.2024 në faqe nr. 5 te pjesa e të gjeturave të Panelit Shqyrtues ka konstatuar se *"për F.K., dëshmia e përvojës nga trusti pensional u pranua si e vlefshme, treguar përvojë mbi 5 vite."* GOE në ankesën e vet në OSHP ka konfirmuar se nuk ka dorëzuar kontratat e punës ose vërtetimet e ATK mirëpo ka kërkuar që pagesat e trustit pensional t'i pranohet si ekuivalente. Në këtë rast nuk ka elaboruar se pagesat e trustit pensional nuk janë bërë për punën profesionale që ka realizuar Faruk Kryeziu si inxhinier pas diplomimit por janë realizuar nga një biznes ku vet Faruk Kryeziu ka qenë pronar (pra nuk bëhet fjalë për përvojë të punës profesionale si inxhinier por si pronar i biznesit të tij). Aq më pak nuk ka potencuar që biznesi në fjalë ku ka qenë pronar Faruk Kryeziu nuk është pjesë e konzorciumit (GOE) që ka ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit. Këtë fakt GOE e ka elaboruar pikërisht në kërkesën për rishqyrtim të datës 05.05.2024. Rrjedhimisht edhe vet Paneli Shqyrtues është vënë në lajthim nga mënyrë e formulimit të pretendimit ankimor. Përndryshe sa i përket faktit se personi në fjalë ka një biznes të tij privat për të cilin ka paguar tatime - trustin pensional, duhet cekur se në kërkesën e dosjes së tenderit është kërkuar që inxhinieri të ketë përvojë të punës profesionale si inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv apo ndërtimi i rrugëve dhe jo përvojë si pronar i biznesit apo përvojë tjetër. Në rastin konkret komisioni ka nxjerrë konstatimin nga vlerësimi i atyre dokumenteve me të cilat ka ofertuar vet parashtruesi. Komisioni as nuk mundet dhe as duhet që të vlerësoj mbi bazën e dokumenteve që nuk janë pjesë e ofertës së parashtruesit. Prandaj mbi bazën e atyre vërtetimeve tatimore që parashtruesi ka dorëzuar është gjetur se personi në fjalë gjatë viteve 2018-2023 i ka vetëm 40 muaj përvojë të punës profesionale dhe nuk i ka 60 muaj përkatësisht 5 vite sikurse është kërkuar me dosje të tenderit. Duke qenë pronar i një biznesi, përvoja e Faruk Kryeziut nuk është përvojë profesionale e tij si inxhinier por është përvojë si ndërmarrës, për më tepër biznesi në fjalë nuk është fare pjesë e GOE që ka ofertuar në këtë AP. Prandaj GOE nuk ka arritur që të përmbushë as këtë kërkesë të DT.
Andaj si rrjedhoj e të lartëcekurave dhe të gjeturave të specifikuara si më lartë, ky komison konstaton se GEO ***"Valdrini ShPK & Ibrahim Kurrumeli BI & LD Construction ShPK"*** është i pa përgjegjëshëm.

-PERGJIGJIA JONË: Ky pretendim i AK nuk qendron , pasi qe Inxhinieri z.Faruk Kryeziu ne Cv-ne e ofruar shihet qarte se ka punuar qe nga viti 2006 e deri me tani dhe ka nje pervoje

pune shume te madhe mbi 17 vite. Po ashtu me sqarimet e kerkuara nga AK kemi ofruar deshmite e kerkuara Pervoja e punes mbi 5 vite permes vertetimave te Atk-se nga viti 2018 deri 2023 te cilet deshmojne se z.Faruk Kryeziu ka pervojen e kerkuar dhe poashtu Faruk Kryeziu ka biznesin e tij personal si person fizik per projektim,ndertim dhe mbikqyrje te projekteve ndertimore te cilin e kemi deshmuar me vertetima te atks per vitet : 2018,2019,2020 per te cilat vite i ka vetpaguar tatimet e tij nga kompania e tij si person fizik dhe poashtu kemi ofruar vertetimat tatimor per vitet 2021,2022 dhe 2023 nga kompania NN Andi Grup ne te cilen punon Faruk Kryeziu dhe i paguhen tatimet ne Atk dhe si i tille Faruk Kryeziu eshte ne Listat e Atk-se qe nga viti 2005 e deri tani.

Poashtu ne kemi ofruar Deshmi Trustin Pensional te ing.Faruk Kryeziu i cili deshmon qartë se Faruku punon nga viti 2005 e deri tani ne kompani te ndryshme me profesion si Inxhinier i diplomuar i ndertimtarise , drejtimi konstruktiv.

Ing.Faruk Kryeziu perveq qe ka punuar ne kompanine e tij inxhinierike si ing ndertimi ,ai ka punuar edhe ne kompani tjera private dhe institucione publike mbi 5 vite, siqe jane :N.N.P MATI-COM ; N.T.SH PATRONI ; MINISTRIA E EKONOMISE.

AK Na eleminon neve si GOE : Valdrini shpk;NN Shkembi & LD Construction shpk me pretendime te pabazuara dhe me kete Ak ka demtuar buxhetin e varfur të Republikes se Kosoves për 449,280.68 € duke shperblyer si fitues i mundshem Ofertuesin e Katërtë me qmimin e ofruar 1,338,169.56 € , ky qmim e tejkalon edhe vleren e parashikuar te projektit nga AK për 238,169.56 € .

Ne kemi marrur qasje edhe ne dokumentet e GOE : FLAMURI V SH.P.K & BENITA COMPANY SH.P.K ,Dhe kemi gjetur shume gabime :

Pretendimet tona per GOE: Flamuri V shpk & Benita Company shpk janë :

1.Te deklarata nenbetim e plotësuar per pronarin Benita Company thuhet se Nexhat Kalludra është drejtor(pozita),ndersa në çertifikaten e biznesit të Benita Company Nexhat Kalludra është pronar ndersa drejtor është Hekuran Kalludra.(Deklarata nenbetim eshte plotesuar me te dhena te pasakta).

2. Sipas dt. Te kerkesat mbi mundesite teknike dhe profesionale kerkohet : Një menaxher I projektit inxhinier I ndertimtarise master ne drejtimin konstruktiv , me sepaku 7 vite pervoje pune profesionale pas diplomimit. Kerkesa: - Diplomat universitare ne baze te kerkesave te kerkura – Kopjet e Noterizuar per secilen diplome te kerkuar; • CV-në e nënshkruar nga kandidati; • Përvojë pune profesionale duhet të dëshmohet përmes kontratës (Kontratave me punëdhënësit) së punës apo vertetimeve te ATK-se .

OE Flamuri v sh.p.k ka ofruar per (menaxher projekti) ing.Skender Rrahmanaj por nuk ka ofruar deshmi as të kontratave të punes as edhe vertetimeve te ATK-së .(Nuk e ploteson kriterin e dyte te kerkesat Pervoja e punes profesionale duhet te deshmohet permes kontrates(kontratave me punedhenesit) se punes apo vertetimeve te ATK-se).

3.CV,e ofruar per ing.Skender Rrahmanaj nuk e plotëson kriterin e pervojes së punes më se paku 7 vite pas diplomimit,në këtë CV nuk deshmohet ndonjë periudhe kohore e punes.

4.Sipas DT. Kerkohet një ing. I ndertimtarise-drejtimi hidroteknikes 5 vite pervoje pune pas diplomimit.OE Flamuri V ka ofruar ing.Burim Sopaj I cili eshte inxhinier I ndertimit , drejtimi :Menaxhimi I ndertimtarise dhe teknologji,me pervoje pune 3 vite pas diplomimit ky ing. Nuk plotëson kriterin e

kerkuar inxh. I hidroteknikes poashtu as edhe pervojen e punes.

5.Sipas DT.kerkohet një ing. I ndertimtarisë drejtimi konstruktiv apo fushës së ndertimit të rrugëve me pervoje 5 vite pas diplomimit. . **Kerkesa: - Diplomat universitare ne baze te kerkesave te kerkura – Kopjet e Noterizuar per secilen diplome te kerkuar; • CV-në e nënshkruar nga kandidati; • Përvojë pune profesionale duhet të dëshmohet përmes kontratës (Kontratave me punëdhënësit) së punës apo vertetimeve te ATK-se .**

OE Flamuri v sh.p.k ka ofruar ing.Lekë Krasniqi ing. I ndertimit me pervoje pune 3 vite e 4 muaj pas diplomimit,nuk plotesohet ky kriter I pervojes 5 vite pas diplomimit ,po ashtu nuk ka ofruar deshmi të pervojes se punes permes kontratave me punëdhënesine dhe as permes vertetimeve të ATK-se sipas kerkeses ne Dt.
(Nuk e ploteson kriterin e dyte te kerkesat Pervoja e punes profesionale duhet te deshmohet permes kontrates(kontratave me punedhenesit) se punes apo vertetimeve te ATK-se.)

6.Sipas dt. Te kerkesat mbi mundesite teknike dhe profesionale kerkohet : Një inxhinier I elektroteknikes-energjetikes apo bachelor 5 vite pervoje pune pas diplomimit . Kerkesa: - Diplomat universitare ne baze te kerkesave te kerkura – Kopjet e Noterizuar per secilen diplome te kerkuar; • CV-në e nënshkruar nga kandidati; • Përvojë pune profesionale duhet të dëshmohet përmes kontratës (Kontratave me punëdhënësit) së punës apo vertetimeve te ATK-se . Ndersa OE Flamuri V ka ofruar ing. Te elektroteknikes Valon Gashi,por nuk ka ofruar deshmi per pervoje të punes sipas kriterit permes kontratave te punes apo vertetimit tatimor.(Nuk e ploteson kriterin e dyte te kerkesat Pervoja e punes profesionale duhet te deshmohet permes kontrates(kontratave me punedhenesit) se punes apo vertetimeve te ATK-se.)

7.Per Ing.Nuri Shabani,mungojne deshmite e pervojes se punes kontratave te punes apo vertetimit të ATK-s.

8.OE ka ofruar ing. Te ndertimtarise-gjeodezise Fisnik Loshi me licence të skaduar per matje gjeodezike,po ashtu I mungojne deshmia e pervojes kontratave te punes apo vertetimave te ATK-se.

9.Mungon Lista e puntoreve e nenshkruar dhe vulosur nga OE, sipas kerkeses se DT kriteri 9.1 dhe 9.2 pika 2.

10. Garancioni I punimeve nuk eshte i nenshkruar dhe vulosur edhe nga partneri I konzerciumit Benita Company Sh.p.k, ne oferten e dorzuar diten e ofertimit.

11.AK ka ofruar Vertetimat e ATK-se per te dy antaret e grupit Flamuri V dhe Benita Company te njejtit kane prezantuar Vertetimat e ATK-se te cilet jane me marrveshje me ATK per shlyerjen e borxheve por nuk kane prezantuar marrveshjen me ATK.(Mungojne marrveshjet me ATK). Certifikata mbi denimet penale per liderin e grupit Flamuri V shpk(Vllaznim Mazreku) e ofruar nuk mund te verifikohen permes Scan codit .

AK ka vepruar ne kundershtim me vendimin e OSHP-së , ku ne vendimin e Panelit shqyrtues te Oshp-se thuhet : AK të veproj në raport me dispozitat ligjore të LLP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.
AK ka vepruar ne menyre te pa rregullt duke na eleminuar ne si GOE te cilet i plotesojme te gjitha kushtet sipas kerkesave ne dosjen e tenderit dhe njoftimit per kontrate.
AK ka vepruar ne menyre te pa rregullt duke shpallur fitues GOE : Flamuri V & Benita Company

te cilet nuk I plotesojne kerkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate dhe jane ne kundershtim me vleren e parashikuar te projektit ku kane ofruar qmim marramendes I cili qmim demton rende buxhetin Komunal.

Dhe si përfundim të nxjerrë:

VENDIM

Me të cilin të vendim të aprovoj kërkesën për rishqyrtim të bazuar të paraqitur nga .*GOE :* **"VALDRINI" SH.P.K ; IBRAHIM KURRUMELI B.I.(NN SHKËMBI) & LD Construction sh.p.k**

- ✓ Te kthej rastin ne rivlerësim dhe vlerësimi të bëhet në pajtim me LPP dhe Rregullat prokurimit publik në Kosovë,
- ✓ Të anuloj njoftimin mbi vendimin e AK-së - B58

Të shpërblej me kontratë **GOE: "VALDRINI" SH.P.K ; IBRAHIM KURRUMELI B.I.(NN SHKËMBI) & LD Construction sh.p.k** sepse janë të përgjegjshëm sipas kritereve të përzgjedhjes dhe të vlerësimit dhe kanë ofruar çmim me te lirë ne mesin e tenderëve të përgjegjshëm.
Mbetemi me shpresë se Kërkesa për Ri-shqyrtim do të shqyrtohet pozitivisht.

Me respekt, Qëndrim Kurrumeli

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzime administrative, Shpenzimet e ankesës 500.00 €, Fitimi i humbur etj.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

BASHKANGJITUR GJENI FAKTET DHE ARGUMENTET LIDHUR ME PRETENDIMET TONA.